

SHËNIMET SHPJEGUESE

PËR PASQYRAT FINANCIARE MBYLLUR më 31 Dhjetor 2018 BURSA E TIRANËS SH.A

- Bursa e Tiranës sh.a ka një kapital aksioner prej 20.000.000 lekë
- Kapital aksioner i derdhur dhe i shpenzuar 2.669.505 lekë
- Kapital aksioner i paderdhur 17.330.495 lekë
- Aksioner i vetëm është Ministri i Financave
- Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 si dhe Ligjin Nr. 9477 datë 09.02.2006 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" të raportuara me monedhen vendese Leke.
- Shoqëria ka bërë ndryshime në politikat e saj kontabël dhe ka përgatitur Pasqyrat Financiare në përputhje me Ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), duke filluar nga data 01.01.2008.
- Me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 126, datë 08.11.2018 **u vendos:** "Për prishjen e shoqërisë Bursa e Tiranës sh.a Tiranë dhe shpalljen e saj në Likuidim".
- Në Aktive Afatshkurta, Mjete monetare, Banka paraqitet me diferencë në pakësim me 2.609.150 lekë e cila vjen nga: Paguesa e sigurimeve shoqërore shëndetësore prill 2015 me 38.006 lekë, nëntor 2018 me 31.778 lekë si dhe përdorimit të Kapitalit aksioner të derdhur për shpenzime nga ish Administratore Xhensila Pine si: Paga e saj dhe Tap 2.351.351 lekë , Gjoha për DRT 110.000 lekë, Gjoha QKB 30.000 lekë , Komisione bankare 48.015 lekë.
- Kapitalit aksioner i derdhur, më 01.05.2015 ka qënë gjëndje 20.643.31 usd kurse më 08.11.2018 kur filloi procesi i Likuidimit ka qënë gjëndje 643.80 usd. Janë përdorur për shpenzime nga ish Administratore 19.999.51 usd e konvertuar 2.534.992 lekë që detajohet në: Paga Tap 2.351.351 lekë, Gjoha 140.000 lekë, Komisione 43.641 lekë. Veprimet në llogarine Bankë Usd janë kryer në datat 31.03.2017 dhe 23.06.2017 sipas Ekstratit të Bankës usd.
- Në Aktive të tjera financiare, Debitorë me 3.807.604 lekë nga kjo: 22.604 lekë për libër i porositur jashtë vendit në vitin 2003 por i pa mbëritur në Bursë dhe 3.785.000 lekë sipas Urdhër zhdëmtimit për ish Administratoren Anila Fureraj në zbatim të Rekomandimit nr.2 të Raportit të Auditimit me shkresë nr. 1437/9 datë 01.04.2015. Ky detyrim nuk është arkëtuar.
- Pagat e mbartura nga viti 2017, të tërhequra më 31 mars 2017 nga ish Administratorja janë 2.110.550 lekë. Tatimi mbi të ardhurat mbi pagën është 240.801 leke, i cili është tërhequr por nuk ka deklarim dhe pagesë për DRT Tiranë.
- Shpenzime për Sigurimeve shoqërore e shëndetësore është 31.778 lekë për nëntor 2018. Nuk janë deklaruar listë pagesat ESIG025 për periudhën maj 2015 deri mars 2017 për Pagat e Ish Administratores.
- Në total Aktivitet Afatgjata Materiale janë 6.525.056 lekë dhe Amortizimi është 5.660.147 lekë.
- Aktivitet Afatgjata Materiale janë në vlerën e tyre neto 864.909 lekë.
- Gjoha për DRT dhe QKB për periudhën maj 2015 - nëntor 2018 janë gjithsej 320.000 lekë. Janë paguar 140.000 lekë, janë për tu paguar edhe 180.000 lekë, nga këto janë apeluar 90.000 lekë gjoha të vitit 2018 me shkresë nr.11, datë. 26.12.2018 sipas Njoftim vleresimit për detyrimet nr.85728/1, datë 24.12.2018 të DRT Tiranë
- Detyrimi i Bursa e Tiranës sh.a ndaj 3 ish punonjeseve të saj sipas Urdhër Ekzekutimeve dhe Vendimeve Gjyqësore të Gjykatave është 3.318.825 lekë.
- Detyrimi i Bursa e Tiranës sh.a ndaj Ekspertes Kontabel është 180.000 lekë.
- Detyrimi për Pagat dhe Sigurimet për muajt nëntor, dhjetor 2018 janë 214.514 lekë.

**Likuidatore
Lindita HYSI**